

OSHEE GROUP sh.a njofton mbi hapjen e vendeve vakante **Specialist** pranë FTL / Drejtoria e Planifikimit dhe Nominimit / Sektori i Nominimit dhe Balancimit.

SPECIALIST

Sektori i Nominimit dhe Balancimit monitoron dhe përgjigjet tek Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Nominimit për trajtimin e çështjeve që lidhen shërbimin operacional të Programimit afat-shkurtër, Nominimin dhe Përditësimit të programeve në platformat e OT duke analizuar dhe përmirësuar vazhdimisht procesin me qëllim të minimizimit të kostove të balancimit.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Nominon programin e energjisë elektrike tek OT për palët e përfshira në proces.
- Vlerëson dhe kontrollon devijimit / disbalancat referuar të dhënave nga OST për grupin e balancimit dhe palët përgjegjëse të grupit të balancimit.
- Garanton respektimin e afateve kohore të rregullave të tregut në lidhje me nominimet e programeve në day –ahead dhe intra-day për palët përgjegjëse balancuse pjestarëse të grupit të balancimit.
- Mbledh të dhënat në lidhje me: ngarkesën, prodhimin e prodhuesve me përparësi, faktorët meteorologjik (temperaturat/reshjet/shi/re/diell).
- Përpunon, analizon dhe parashikon konsumin/prodhimin e energjisë në terma afat-shkurtër bazuar në të dhënat në dispozicion (ditore/orare/15 min).
- Ndjek në vazhdimësi dinamiken e ndryshimit të programeve të dërguara nga PPB e grupit, ndryshimin e prodhimit nga BREE apo konsumit dhe në koordinim me dispecerinë e KESH-it bën ndryshimet e nevojshme në skedulimin e gjenerimit dhe konsumit.
- Shqyrtimin dhe përditësimin e parashikimit në afatet kohore të përshtatshme sipas rregullave të tregut në fuqi.
- Bazuar në informacionin që merr në kohe reale nga sistemi i kontroll-monitorimit OST dhe i menaxhimit të rrjetit OSSH, vlerëson dhe kontrollon devijimit / disbalancat për grupin e balancimit dhe azhuron programet e nominimit.
- Agregimi i i programeve të dërguara nga PPB e Grupit

- Paraqet programin e energjisë tek palët përkatëse në kohën e duhur.
- Garanton respektimin e afateve kohore të rregullave të tregut në lidhje me nominimet e programeve në day –ahead dhe intra-day për palët përgjegjëse balancuse pjestarëse të grupit të balancimit.
- Përgatit raporte të detajuara sipas kërkesave të eprorëve.
- Aktivitete të tjera, të ngarkuara nga eprori i drejtëpërdrejtë.
- Bashkëpunon, me ekipin e departamentit dhe me stafin e departamenteve të tjera.
- Detyra të tjera, të ngarkuara nga Eprori i drejtëpërdrejtë.

Kualifikimet dhe kërkesat:

- Të ketë përfunduar Fakultetin për Matematikë/ Ing Matematikë/Inxhinieri Elektrike/, diplomë e nivelit “Master Shkencor” dhe të ketë kualifikime/specializime/trajnime të ndryshme.
- Të ketë një përvojë pune mbi 3-vjet, preferohet në fushën e energjisë.
- Njohje dhe aftësi në përpunimin e serive numerike kohore.
- Të jetë i/e aftë të përpilojë, analizojë dhe përgatisë raporte dhe të dhëna specifike që lidhen me fushën e veprimtarisë.
- Aftësi të mira (MS Office) etj.
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të aftë të punojnë në grup.
- Të njohë gjuhë të huaja, preferohet gjuha angleze.
- Të jetë i gatshëm të punojë me turne dhe në fundjavë.

Të gjithë kandidatët e interesuar janë të lutur të bëjnë aplikimin në websiten e OSHEE group, në portalin e punësimit.

Ju njoftojmë se vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë.